



- *Ulje e normave referente të interesit nga ana e BQE-së*
- *Shqetësim për tarifën shtesë ndaj Kinës edhe përkrah mundësisë për fillim të bisedimeve tregtare me ShBA-në*
- *Korrigjim i fortë në rënie i normave të kthimit të obligacioneve qeveritare në ShBA*

Në qendër të vëmendjes së investitorëve të tegjeve ndërkombëtare financiare ishin politikat tregtare botërore dhe mbledhja e BQE-së. Në fillim të javës u shënua korrigjim i ndjeshëm në rënie i normave të kthimit të obligacioneve qeveritare në ShBA, pas rritjes së javës paraprake. Lëvizje të tilla erdhën për shkak të qetësisë të përkohshme të shqetësimeve të shkaktuara nga tensionet tregtare, pasi ShBA-të vendosën të përjashtojnë telefonat inteligjentë dhe kompjuterët nga fusha e tarifave të shpallura më parë. Përkrah kësaj, për këtë korrigjim kontribuoi edhe shpallja nga ana e administratës së ShBA-së që është arritur përparim i konsiderueshëm në negociatat tregtare me BE-në¹. Përgjatë javës, normat e kthimit edhe më tej u ulën, për shkak të paralajmërimit për mundësi të futjes së tarifave të reja për importet e mineraleve të rëndësishme në ShBA. Pas këtij njoftimi, tensionet me Kinën u forcuan dhe pasiguria rreth zinxhirëve globalë të furnizimit u rrit². Pasojat ishin rritje e shqetësisë tek investitorët, veçanërisht për ndërprerjet e mundshme në industrinë që varen nga këto lëndë të para strategjike, të cilat çuan në rritje të kërkesës për instrumente financiare të sigurta. Në kushte të tilla, normat e kthimit të obligacioneve qeveritare amerikane në segmentet 2, 5 dhe 10 vjeçare në bazë javore ranë mesatarisht për 18 pikë bazike. Për shkak të kërkesës në rritje për instrumente të sigurta, çmimi i arit arriti nivel të ri historik prej mbi 3.300 dollarë amerikanë për ons. Në të njëjtën kohë, indekset e tregut të aksioneve dhe vlera e dollarit amerikan kundrejt euros ra në bazë javore. Kursi i këmbimit euro/dollar amerikan karakterizohet me ndryshim të caktuar, nga ku rënia e parë e palës valutore e shkaktuar nga mundësia për qetësim të luftës tregtare dhe ulje të normave referente të interesit nga ana e BQE-së, e cila është kompensuar plotësisht nga shqetësimet në rritje pas njoftimit të futjes së mundshme të tarifave të reja për importet e mineraleve të rëndësishme në ShBA. Nga ana tjetër, çmimet e naftës u rritën për shkak të fillimit të mundshëm të negociatave tregtare midis ShBA-së dhe Kinës, pasi Kina shprehu gatishmërinë e saj për dialog nëse ShBA-të tregojnë qëndrueshmëri në vendimet e tyre.

Në eurozonë, përkrah efekteve të ShBA-së, edhe mbledhja e BQE-së pati ndikim të fuqishëm mbi tregjet, nga ku erdhi edhe në rënie të normave të kthimit të obligacioneve qeveritare, veçanërisht për shkak të ngadalësimit të vërejtur të presioneve mbi çmimet dhe rritjes së rreziqeve negative për rritjen ekonomike. Si pasojë, normat e kthimit të obligacioneve qeveritare ranë mesatarisht për rreth 10 p.b. në segmentet 2, 5 dhe 10 vjeçare³. Në pajtim me pritshmëritë, BQE-ja i uli të tre normat referente të interesit për 25 pikë bazike (ulja e shtatë që nga qershori i vitit 2024, nga ku ndryshimi total shënon 175 p.b.)⁴. Në njoftimin për shtyp të bankës qendrore u theksua që të dhënat e çmimeve tregojnë në avancim të procesit të dezinfacionit, me rënie të inflacionit dhe inflacionit bazë në mars, si dhe ngadalësim të rëndësishëm të rritjes së çmimit të shërbimeve⁵. Kryetarja e BQE-së, Kristina Lagard, në fjalimin e saj theksoi që në këto kushte nuk është e rëndësishme të flitet për shtrëngimin e politikës monetare dhe që norma neutrale e interesit është koncept që është i përshtatshëm për botën pa tronditje, gjë që nuk është rasti tani. Ajo shtoi që BQE-ja do të zgjedhë politikë të përshtatshme, e cila do të bazohet në gatishmërinë dhe shkathtësinë për t'u përballur me tronditjet e ardhshme. Në kushtet aktuale, sipas Lagard, mbizotërojnë rreziqet negative për rritjen ekonomike dhe nëse ato realizohen, do të rishikohen masa shtesë. Sa i përket treguesve makroekonomikë në zonën e euros, rritja mujore e prodhimit industrial u përshpejtua në shkurt, duke u rritur nga 0,6% në 1,1%, kryesisht për shkak të rritjes së prodhimit të mallrave kapitale dhe mallrave jo të qëndrueshme. Nga ana tjetër, besimi i investitorëve në Gjermani në prill, i matur

¹ Në këtë kontekst, u theksua gjithashtu se po shqyrtohet mundësia e futjes së përjashtimeve të caktuara për makinat dhe pjesët e importuara të automjeteve.

² Në të njëjtën kohë, ShBA-të e kuptojnë varësinë e tyre të tepërt nga Kina, e cila është prodhuesi kryesor i 30 nga 50 mineraleve të rëndësishme, veçanërisht pasi Pekini filloi të kufizojë eksportet e tyre.

³ Revizionin në rritje i rejtingut kreditor në Itali nga ana e agjencisë për rejting kreditor S&P solli në rënie të normave të kthimit të obligacioneve qeveritare italiane dhe spanjolle.

⁴ Pas këtij ndryshimi, norma e interesit të depozitave njëditore shënon 2,25%, norma e refinancimit 2,4%, ndërsa norma e interesit e kredive njëditore shënon 2,65%.

⁵ Për dallim nga mbledhja e mëparshme, deklarata e fundit nuk tregoi që politika monetare është dukshëm më pak e shtrënguar. Me këtë, BQE-ja synon të sigurojë stabilizim të qëndrueshëm të inflacionit drejt nivelit të objektivit afatmesëm, në mes të pasigurisë në rritje, ndaj do të vazhdojë të marrë vendime në varësi të të dhënave ekonomike, nga mbledhja në mbledhje. Në të njëjtën kohë, Këshilli nuk angazhohet për rrugë specifike të normës së interesit.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

RISHIKIM JAVOR I ZHVILLIMEVE NË TREGJET NDËRKOMBËTARE FINANCIARE

7 – 11 prill 2025

përmes indeksit ZEV, ra ndjeshëm nga 51,6 në -14 pikë, duke hyrë në zonën treguese të recesionit për herë të parë që nga tetori 2023, ndërsa regjistroi edhe rënien më të madhe që nga invazioni rus mbi Ukrainën në vitin 2022⁶.

Në Kinë, rritja vjetore e PBB-së në tremujorin e parë ishte 5,4% (më e lartë se pritjet e analistëve prej 5,1%) dhe u mbështet nga konsumi i fortë personal dhe prodhimi industrial.⁷ Megjithatë, analistët paralajmërojnë se rritja mund të ngadalësohet ndjeshëm për shkak të efekteve të mundshme negative të tarifave të reja të vendosura nga ShBA-të.

[Banka e Kanadasë](#) e mbajti normën e interesit në 2,75%, duke i dhënë fund serisë prej shtatë uljesh të njëpasnjëshme për shkak të pasigurisë në rritje mbi politikat tregtare të ShBA-së. Guvernatori theksoi se banka do të veprojë me kujdes, duke monitoruar sinjalet ekonomike me qëllim të mbajtjes nën kontroll të inflacionit dhe mbështetjen e rritjes ekonomike.

Tregues të zgjedhur të tregut

Kurset valutore	11.04.	18.04.	ndryshimi javor	ndryshimi që nga fillimi i vitit
EUR/USD	1.1355	1.1393	0.3%	10.0%
EUR/GBP	0.8684	0.8571	-1.3%	3.6%
EUR/CHF	1.0821	1.0745	-0.7%	0.8%
EUR/JPY	163.03	161.97	-0.7%	-0.5%
EUR/CAD	1.5755	1.5777	0.1%	6.0%
Tregu i parasë	11.04.	18.04.	ndryshimi javor	ndryshimi që nga fillimi i vitit
Euribor 1w (%)	2.39	2.31	-8.2 6.n.	-61.7 6.n.
Euribor 1m (%)	2.30	2.13	-17 6.n.	-71.1 6.n.
Euribor 3m (%)	2.28	2.18	-9.6 6.n.	-53.1 6.n.
Euribor 12m (%)	2.17	2.10	-6.3 6.n.	-35.6 6.n.
USD SOFR 1w (%)	4.34	4.33	-1.1 6.n.	0.3 6.n.
USD SOFR 1m (%)	4.33	4.33	-0.3 6.n.	0.2 6.n.
USD SOFR 3m (%)	4.27	4.28	1.2 6.n.	-1.7 6.n.
USD SOFR 12m (%)	3.94	3.86	-7.6 6.n.	-31.5 6.n.
Obligacione shtetërore	11.04.	18.04.	ndryshimi javor	ndryshimi që nga fillimi i vitit
Schatz 2y (%)	1.79	1.69	-10.3 6.n.	-39.6 6.n.
OBL 5y (%)	2.13	2.02	-11.3 6.n.	-13.5 6.n.
Bund 10y (%)	2.57	2.47	-9.8 6.n.	10.5 6.n.
UST 2y (%)	3.96	3.80	-16.2 6.n.	-44.3 6.n.
UST 5y (%)	4.16	3.94	-22.2 6.n.	-44.4 6.n.
UST 10y (%)	4.49	4.32	-16.5 6.n.	-24.4 6.n.
Aksionet	11.04.	18.04.	ndryshimi javor	ndryshimi që nga fillimi i vitit
Indeksi STOXX 50	4,787	4,935	3.1%	0.8%
Indeksi S&P 500	5,363	5,283	-1.5%	-10.2%
Indeksi Dow Jones	40,213	39,142	-2.7%	-8.0%
Indeksi Nasdaq	16,724	16,286	-2.6%	-15.7%
Produktet e mallrave	11.04.	18.04.	ndryshimi javor	ndryshimi që nga fillimi i vitit
Ar (\$/Oz)	3,214	3,324	3.4%	27.3%
Naftë (Brent, \$/barrel)	66.0	68.2	3.4%	-9.5%
Gaz natyror (EUR/MWh)	33.4	35.7	6.8%	-26.5%
Energji el. (EUR/MWh)	84.9	72.0	-15.2%	-13.7%
Metale (Indeks)	271.4	276.4	1.9%	2.5%

⁶Të dhënat e pafavorshme pasqyrojnë plotësisht pritjet në përkeqësim të investitorëve për perspektivat e ardhshme ekonomike, të ndikuara nga pasiguria e shkaktuar nga tarifat amerikane. Kështu, pesimizmi i investitorëve zëvendësoi plotësisht disponimin pozitiv të shkaktuar nga njoftimet për shpenzime të gjera në mbrojtje dhe infrastrukturë në Gjermani.

⁷Analizuar në bazë tremujore, rritja e PBB-së u ngadalësua nga 1,6% në 1,2%.